

Refik Ramadani, PhD. (c)<sup>1</sup>  
Ragmi Mustafa, Prof. Assoc.<sup>2</sup>

UDC: 376-056.26/.36:004(497.115)

**BAZAT TEORIKE DHE DIDAKTIKE TË EDUKIMIT TË  
TEKNOLOGJISË INFORMATIVE NË SHKOLLË, PËRVOJA NË  
VENDIN TIM, KOSOVË**

**ТЕОРЕТСКИ И ДИДАКТИЧКИ ОСНОВИ НА ОБРАЗОВАНИЕТО  
ПО ИНФОРМАТИЧКА ТЕХНОЛОГИЈА ВО УЧИЛИШТЕ,  
ИСКУСТВО ВО МОЈАТА ЗЕМЈА, КОСОВО**

**THEORETICAL AND DIDACTIC BASICS OF INFORMATION  
TECHNOLOGY EDUCATION AT SCHOOL, EXPERIENCE IN MY  
COUNTRY, KOSOVO**

**Abstract**

This research is based on only informatics education for learners with disabilities in schools. This process included the school for blind learners “Xheladin Deda” in Peja, the school for learners with hearing impairments “Mother Teresa” in Prizren, the special school for learners with intellectual disabilities “Mother Teresa” in Mitrovica, the special school for learners with intellectual disabilities “Lef Nosi” in Prizren, and the special school for learners with intellectual disabilities “Përparimi” in Prishtina.

**Keywords:** technology; education; school; disabilities

---

<sup>1</sup> Author Refik Ramadani is in the end of his doctoral studies at St Cyril and St Methodius *University of Veliko Tarnovo Bulgaria* (refik.ramadani@uni-gjilan.net).

<sup>2</sup> Author Ragmi Mustafa is Prof. Assoc. at Public University “Kadri Zeka”, Gjilan, Republic of Kosovo (ragmi.mustafa@uni-gjilan.net).

## Hyrje

Në Republikën e Kosovës, në dy dekadat e fundit, rol të veçantë në mbështetjen e arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me nevoja të veçanta kanë dhënë organizatat vendore dhe ndërkombëtare, ku pas përfundimit të luftës në vitin 1999, prania shumëkombëshe në administrim ndërkombëtar, bëri të mundshme që Kosova të merrte përvoja nga shumë vende evropiane në trajtimin e edukimit special. Edhe institucionet ndërkombëtare para periudhës së pavarësisë së Kosovës, edhe ato shtetërore pas Deklaratës së Pavarësisë më 2008, hartuan dhe miratuan një sërë ligjesh, udhëzimesh administrative dhe masa për mbrojtjen e arsimit gjithëpërfshirës dhe avancimin e edukimit special. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është autoriteti kryesor qeveritar që krijon politikat arsimore në nivel republikan, ndërsa në nivel komunal, komunat, specifikiisht Drejtoritë Komunale të Arsimit, kanë kompetenca të gjera në organizimin, sistemimin dhe menaxhimin e arsimit.

Në kuadër të Ministrisë së Arsimit, është i veçantë një divizion, që merret kryesisht me çështjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara, i quajtur “Divizioni për arsim me nevoja të veçanta”. “Divizioni për arsimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në fushëveprimin e saj përfshin hartimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave për:

- Nxënësit me aftësi të kufizuara dhe me vështirësi në të nxënë
- Fëmijët/nxënësit e fëmijëve/nxënësve me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente të veçanta në fusha akademike kreative dhe artistike.” (MASHT, n.d.)

Divizioni i lartpërmendur publikon dokumente për fëmijët/nxënësit me aftësi të kufizuara dhe me vështirësi në të nxënë, si dhe për fëmijë/nxënës me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente të veçanta në fusha akademike, kreative dhe artistike. Ndërsa mësimi për fëmijët me aftësi të kufizuara zhvillohet në të ashtuquajturat “qendra burimore”. “Qendrat burimore janë nën administrim të MASHT-it dhe do të ofrojnë shërbime të mbështetjes për të gjitha shkollat e rregullta në gjithë Kosovën dhe organizojnë mësim për fëmijët me aftësi të kufizuara të rënda dhe të shumëfishta. Ristrukturimi i shkollave speciale përfshin ndryshimin e shkollave speciale në përmbajtje dhe strukture çka do të thotë se do të ndryshojë mënyra e qasjes se mësimdhënies në këto shkolla mënyra e funksionimit e cila është e ndare në dy njësi:

1. Shkollë speciale për fëmijët me dëmtime të rënda
2. Njësia e shërbimeve të mbështetjes.” (MASHT, Funkcionalizimi i qendrave burimore, 2015)

Shkollat speciale kanë detyra të veçanta që nga funksionimi i tyre në vitin 2002, të cilat ndërlidhen me mësimdhënien, mësimnxënien, programet dhe planet e veçanta individuale. Sipas Ministrisë së Arsimit, këto janë detyrat e shkollave speciale:

- “1. Mësimdhënia për fëmijët me dëmtime të rënda dhe të shumëfishta

2. Akomodimi i nxënësve në konvikt (mundësia e akomodimit edhe të prindërve të fëmijëve në rastet kur kanë nevojë derisa të përshtatet fëmija dhe për fëmijët e shkollave të rregullta që vinë për një kohë të shkurtër në qendër burimore)

3. Krijimi i programit për përgatitje të nxënësve që do të vinë në shkollë, d.m.th. nxënësve të rinj për t'u përshtatur (Para se të filloj shkolla, para shtatorit, marrja e informatave nga familja)

4. Përpilimi i planeve shkollore sipas specifikave të shkollës bazuar në kurrikulën kombëtare shtetërore

5. Përpilimi i planeve individuale të arsimit për të gjithë fëmijët që janë në shkollë

6. Një arsimtare punon me klasën deri në klasën e 5-të, pas klasës së pestë duhet të fillohet me organizim të tillë që të mos bëhet mësimdhënia sipas arsimtarëve lëndorë, por një grup prej 3-4 mësimdhënësish të jenë përgjegjës për një klasë, një për shkencat shoqërore, një për shkencat natyrore, një për lëndë të shkathtësive dhe arsimtari i gjuhës angleze sipas nevojave të shkollës

7. Për arsimin e mesëm të lartë varësisht nga drejtimi, një duhet të jetë për lëndët e përgjithshme dhe 1 për lëndët profesionale dhe 1 për punën praktike

8. Detyrat e stafi të kujdesit ditor dhe konviktit duhet të përshtaten ashtu që të jenë në gjendje të kujdesen për të gjitha nevojat personale të fëmijëve (si p.sh. kujdesi higjienik, ndërrimi i pelenave etj.). Të dyja, njësia e shkollës dhe njësia e shërbimeve të mbështetjes, duhet të bashkëpunojnë shumë ngushtë në shkëmbimin e informatave, dijes, ekspertizës, hulumtimit Odhe burimeve për një funksionim të mirë.” (MASHT, Funksionalizimi i qendrave burimore, 2015)

### **Hulumtimi**

Për shkak që hulumtimi ynë bazohet vetëm në edukimin informatik për nxënësit me aftësi të kufizuara në shkolla, kemi ndarë përgjegjësitë e Njësisë së Shërbimeve të Mbështetjes, e cila ofron pajisjet teknike për nxënësit me nevoja të veçanta dhe çdo gjë që ndërlihet me edukimin informatik. Madje, ekziston Grupi për mbështetje teknike, grup i veçantë i vlerësimit, rehabilitimit dhe hartuesit e materialeve mësimore, që merren direkt me edukimin informatik. Në bashkëpunim me këtë Grup për Mbështetje Teknike, janë edhe: koordinatori, arsimtarët udhëtues (në bazë të nevojave dhe zonës së mbulimit). “Detyrat e njësisë së shërbimeve të mbështetjes janë:

1. Identifikimi dhe referimi për vlerësim të fëmijëve që janë jashtë shkollës dhe ata që janë në shkollë dhe institucione parashkollore dhe që kanë nevojë për mbështetje;

2. Mbështetja për institucionet parashkollore dhe shkollat e rregullta dhe prindërit;

3. Mbështetja e nxënësve dhe arsimtarëve në shkolla të rregullta përmes arsimtarëve udhëtues;

4. Në formë të punës praktike në klasë me nxënës;
5. Zhvillimi, hartimi dhe shpërndarja e materialeve ndihmëse mësimore për nxënës;
6. Ofrimi i këshillave për arsimtarë të rregullt si të punohet me nxënës;
7. Organizimi i kurseve trajnuese për arsimtarë dhe prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe vështirësi në të nxënë që janë në shkolla të rregullta;
8. Ofrime i kurseve të shkurta në qendër burimore për nxënësit e shkollave të rregullta të cilat kanë nevojë të mësojnë ndonjë teknikë të mësimin apo që kanë nevojë për vlerësim apo rehabilitim dhe mbështesin fëmijët në periudhat e tranzicionit;
9. Vlerësimi i nxënësve të shkollave me aftësi të kufizuar dhe vështirësi në të nxënë;
10. Ofrimi i pajisjeve teknike dhe mësimore për nxënësit me aftësi të kufizuar dhe vështirësi në të nxënë;
11. Bashkëpunimi me OJQ-të e personave me aftësi të kufizuar në identifikimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe vështirësi në të nxënë;
12. Krijimi i rrjetit të qendrave burimore për të mbuluar mirë gjithë territorin e Kosovës;
13. Bashkëpunimi me ekipet vlerësuese dhe mbështetëse komunale për vendin se ku do të vendoset fëmija me aftësi të kufizuar dhe vështirësi në të nxënë dhe mbështetja që i nevojitet;
14. Organizimi i fushatës së vetëdijesimit për prindër dhe komunitetin për arsim gjithëpërfshirës;
15. Bashkëpunimi me arsimtarët gjithëpërfshirës në koordinimin e mbështetjes për nxënës me aftësi të kufizuar dhe vështirësi në të nxënë;
16. Hulumtimet në metodat dhe teknikat e ndryshme moderne mësimore dhe publikimi i rezultateve të mira.” (MASHT, Funkcionalizimi i qendrave burimore, 2015)

### **Rëndësia e punimit**

Përveç këtyre detyrave të përshkruara, është e mbajtja e databazës për mbështetjen që ofrojnë për shkollat e rregullta dhe për gjithë punën që bëjnë dhe t’i raportojnë rregullisht menaxhmentit të Qendrës Burimore. “Në bazë të këtij propozimi qendrat burimore bazuar në specifikat e tyre kanë bërë planet e ristrukturimit të shkollave të tyre. Në këtë proces janë përfshirë shkolla për nxënësit e verbër “Xheladin Deda” në Pejë, shkolla për nxënësit me dëmtime në të dëgjuar “Nënë Tereza” në Prizren, shkolla speciale për nxënësit me dëmtime intelektuale “Nënë Tereza” në Mitrovicë dhe shkolla speciale për nxënësit me dëmtime intelektuale “Lef Nosi” në Prizren. Ndërsa shkolla speciale për nxënësit me dëmtime intelektuale “Përparimi” në Prishtinë do të bëjë ristrukturimin pas kalimit në objektin e ri i cili është në ndërtim e sipër.”

Në tabelën nr. 1 (ZyraeKryeministrit, 2009), paraqiten shkollat speciale në Kosovë dhe numri i nxënësve djem dhe vajza, si dhe totali i tyre për çdo shkollë speciale, ku dominojnë disa nga qytetet dhe komunat më të mëdha të Kosovës, me përjashtim të Shtimes, që është komunë më e vogël dhe qytezë.

Tabela 1 – Shkollat speciale në Kosovë

Numri	Komuna/ Rajoni	Numri i fëmijëve		
		Djem	Vajza	Totali
1	Mitrovicë	41	20	61
2	Pejë	34	21	55
3	Prishtinë	54	46	100
4	Prizren	68	29	97
5	Prizren	50	16	66
6	Shtime	2	3	5
Totali		249	135	384

Sa i përket llojit të aftësive të kufizuara, dominojnë ato në fushën intelektuale, në fushat e shumëfishta, më pas në shqisën e dëgjimit, duke vazhduar në atë të shikimit. Për më shumë, shih tabelën nr. 2.

Tabela 2 (ZyraeKryeministrit, 2009). Llojet e aftësive të kufizuara

Lloji i aftësisë së kufizuar	Djem	Vajza	Totali
Intelektuale	78	36	114
Dëgjimi	57	25	82
Shikimi	34	21	55
Fizike	4	0	4
E shumëfishtë	76	53	129
Totali	249	134	384

Në tabelën nr. 3, prezantohen të dhënat mbi klasat speciale të bashkëngjitura në Kosovë dhe numri i fëmijëve sipas klasave, ku sipas dokumentit qeveritar, në vitin 2009, një vit pas Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, në Kosovë kishte më së shumti nxënës në klasën e pestë (131 në total, prej tyre 83 djem dhe 48 vajza), kurse në klasën e nëntë, më së paku. Në total, numri i tyre është 9, ku prej tyre, 7 janë djem dhe 2 janë vajza. Pra, duke vijuar nivelin e klasës sa më lart, numri i tyre bie, gjë që tregon se rriten sfidat sidomos për klasat më të larta.

Tabela 3 (Zyra e Kryeministrit, 2009). Të dhëna mbi klasat speciale të bashkëngjitura në Kosovë -Numri i fëmijëve sipas klasave

Nr.	Klasa	Totali	Djem	Vajza
1	Klasa 1	44	21	23
2	Klasa 2	74	53	21
3	Klasa 3	41	20	21
4	Klasa 4	72	43	29
5	Klasa 5	131	83	48
6	Klasa 6	77	47	30
7	Klasa 7	27	17	10
8	Klasa 8	12	9	3
9	Klasa 9	9	7	2
Totali		487	300	187

Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara që nuk janë as në shkollat e integruara, as në klasat speciale të bashkëngjitura, nuk dihet, sikurse nuk ka të dhëna të plota mbi numrin total të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë. “Megjithatë, Regjistrimi i vitit 2011 gjithashtu grumbullon të dhëna lidhur me numrin e njerëzve që raportojnë se kanë vështirësi në kryerjen e aktiviteteve të përditshme, si dhe me shkallën e vështirësisë... 880 fëmijë të moshës 0-19 vjeç janë raportuar të kenë ca vështirësi për të mësuar, për t’u kujtuar apo përqendruar, 694 fëmijë janë raportuar të kenë ca vështirësi për t’u veshur, pastruar dhe për të kryer aktivitete përreth shtëpisë, 614 fëmijë janë raportuar të kenë ca vështirësi për të dalë jashtë shtëpisë të vetëm për të blerë ose vizituar mjekun, 510 fëmijë janë raportuar të kenë ca vështirësi në punë ose në biznes ose në shkollë ose kolegji dhe 599 fëmijë janë raportuar të kenë ca vështirësi për të marrë pjesë në aktivitete të tjera. Po ashtu, 520 fëmijë të moshës 0-19 vjeç janë raportuar të kenë shumë vështirësi për të mësuar, për t’u kujtuar ose përqendruar, 398 fëmijë janë raportuar të kenë shumë vështirësi për t’u veshur, pastruar dhe për të kryer aktivitete përreth shtëpisë, 614 fëmijë janë raportuar të kenë shumë vështirësi për të dalë jashtë shtëpisë të vetëm për të blerë ose vizituar mjekun, 510 fëmijë janë raportuar të kenë shumë vështirësi në punë ose në biznes ose në shkollë ose kolegji dhe 599 fëmijë janë raportuar të kenë shumë vështirësi për të marrë pjesë në aktivitete të tjera. Siç pritej, numri i fëmijëve të raportuar të listuar në kategorinë nuk mund ta bëjë fare, është shumë më i lartë se në dy kategoritë e mëparshme. Aktivitetet e listuara nuk marrin në konsideratë standardet krahasuese (benchmarks) zhvillimore dhe janë aktivitete që kërkohen në përgjithësi nga një i rritur, dhe thjesht të përshatura të gjitha moshave në këtë regjistrim. Prandaj, të dhënat duhet të interpretohen me kujdes...” (Hunt & Belegu-Caka, 2017)

Ndërsa në raportet e tjera të organizatave ndërkombëtare në Kosovë, regjistroheshin këto të dhëna të personave me aftësi të kufizuara: “Kosova ka

346.000 studentë, prej të cilëve, rreth 1000 janë identifikuar zyrtarisht si persona me nevoja të veçanta. Personat e identifikuar, studiojnë në klasa speciale të shkollave të rregullta që quhen klasa të bashkëngjitura ose në shkolla speciale. Rreth 10.000 fëmijë nuk vijnë në mësimin. Shumica e tyre, 7000 llogaritet të jenë fëmijë me nevoja të veçanta. Ata përfaqësojnë 13 për qind të popullsisë së llogarit të fëmijëve me nevoja të veçanta në Kosovë. Mbi 40.000 fëmijë me probleme serioze në mësimnxënie mësojnë në klasa të rregullta, por meqë nevojat e tyre nuk janë identifikuar, prandaj edhe nuk janë përmbushur. Programet për të zbutur këtë gjendje ekzistojnë, por zbatohen shumë ngadalë. Arsyet kryesore të kësaj qëndrojnë në mendimin konservativ si dhe në problemet ekonomike dhe sociale. Ky raport rekomandon përdorimin e metodave jokonvencionale për të shpejtuar procesin dhe që t'i qasen më me arsye arsimit gjithëpërfshirës gjatë dhjetë vjetëve të ardhshëm. Ky raport synon identifikimin e nevojave të fëmijëve që sistematikisht janë përjashtuar nga sistemi arsimor dhe sigurimin për aktorët relevantë, rekomandimet me qëllim që të ecin përpara me përfshirjen e plotë të çdo fëmije në sistemin arsimor.” (UNMIK, n.d.)

Për këtë hulumtim, ne kemi bashkëpunuar edhe me **Shoqatën e të Shurdhërve “Anamorava” në Komunën e Gjilanit, e cila vepron në nivel lokal, në kuadër të Shoqatës Kosovare për të Shurdhrit. Historiku i shoqatës në nivel të Kosovës, shkon në vitet pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore.** “Shoqata Kosovare e të Shurdhërve është themeluar në vitin 1949 dhe në atë kohë kishte shtatë klube, në shtatë qendrat e Kosovës. Të gjitha klubet kanë qenë të udhëhequr nga njerëz që dëgjojnë. Pas përfundimit të luftës në Kosovë komuniteti i të shurdhërve u kthye prapë në shtatë klube, por e kishin shumë të vështirë të menaxhonin me klubet e tyre për shkak se klubet gjithmonë ishin udhëhequr nga personat që dëgjojnë. Në atë kohë nuk kishte kontakte bashkëpunuese në mes të klubeve rreth aktiviteteve të tyre.” (SHKSH, 2021)

Pas përfundimit të luftës në Kosovë në vitin 1999 dhe instalimit të administratës civile e ushtarake ndërkombëtare, u riorganizuan të gjitha shoqatat e klubet, duke u mbështetur fuqishëm sidomos nga vendet evropiane e skandinave. “Me kërkesë të komunitetit të shurdhër në vitin 2000 është bërë një hulumtim rreth situatës së komunitetit të shurdhër në Kosovë nga ana e Shoqatës Finlandeze të Shurdhërve dhe në fillim të vitit 2001 është organizuar një seminar me përfaqësues komuniteti i të shurdhërve për të diskutuar të dhënat e hulumtimit. Në bazë të këtij hulumtimi, përfaqësuesit e shurdhër identifikuan tre objektivat kryesore;

1. Trajnimi organizativ për të ngritur kapacitetet e komunitetit të shurdhër në klubet e tyre lokale
2. Trajnime për interpretët e gjuhës së shenjave për të përmbushur nevojat e komunitetit të shurdhër për qasje në informacione

3. Nevoja për hulumtimin e gjuhës së shenjave me qëllim të dokumentimit të gjuhës së shenjave dhe prodhimit të materialeve trajnuese në gjuhën e shenjave.

Në vitin 2002, grupi punues ka përgatitur projekt propozimin dhe ka aplikuar në Shoqatën Finlandeze të Shurdhërve. Në vitin 2003 Shoqata Finlandeze e të Shurdhërve ka filluar përkrahjen e komunitetit të shurdhërve në Kosovë dhe që nga viti 2004 ka filluar puna me rekrutimin e stafit. Grupi punues u shndërrua në Komitetin Drejtues të Projektit, i përbërë nga përfaqësues nga klubet lokale të shurdhërve me qëllim implementimin e projektit. Fokusi i Komitetit Drejtues ka qenë zhvillimi i statuteve të standardizuar për shoqatat lokale dhe statutin për shoqatën nacionale. Pas themelimit të shoqatave lokale në vitin 2007 është themeluar shoqata nacionale (Shoqata Kosovare e të Shurdhërve). Dhe për herë të parë në historinë e komunitetit të shurdhërve anëtarët kanë zgjedhur trupin e tyre përfaqësues, bordin e Shoqatës Kosovare të Shurdhërve.” (SHKSH, 2021)

Ne gjatë hulumtimit, kemi intervistuar edhe Shpresa Sejdiun, e cila është profesore dhe interprete e gjuhës së shenjave, si dhe drejtorin e shkollës fillore “Rexhep Elmazi”, i cili na mundësoi të realizojmë hulumtimin me nxënësit me aftësi të kufizuara, që ndjekin mësimet në këtë shkollë, si dhe Kryetarin e Shoqatës së të Verbërve në Gjilan. Gjendja e personave me aftësi të kufizuara, vazhdon të jetë jo e kënaqshme, por janë bërë përpjekje institucionale, qeveritare dhe joqeveritare, që të përkrahen me legjislacion të ri, strategji e plane.

“Miratimi i Ligjit për Personat e Verbër, Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Personave me Paraplegji dhe Tetraplegji, si dhe zbatimi i Rregullores së QRK për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave në institucione publike për personat e shurdhër kanë qenë disa nga veprimet që janë përmbushur dhe që kanë arritur të ndikojnë drejtpërdrejt në standardin dhe kushtet e jetesës së përfituesve të kësaj kornize ligjore.” (Zyra e Kryeministrit, 2018)

Plani Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2015 është hartuar paralelisht me Strategjinë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, ndërsa në vitin 2018, është bërë edhe Plani i Dytë Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2018-2020. Në kuadër të këtyre strategjive, janë bërë disa përmirësime për personat me aftësi të kufizuara në arsimim. “Në kuadër të rritjes së kapaciteteve për fushën e arsimit gjithëpërfshirës janë punësuar 9 edukatorë mbështetës për nivelin parashkollor dhe 28 mësimdhënës mbështetës për shkolla të rregullta. Programi 3 vjeçar 2013-2015 për aftësimin e 17 asistentëve dhe inspektorëve të gjuhës së shenjave është një program tjetër, i cili ka aftësuar personat e parë në Kosovë për përdorimin e gjuhës standarde të shenjave. Gjithnjë në kuadër të ngritjes së kapaciteteve një fokus i madh i është dhënë trajnimeve nga programe të ndryshme ku janë përfshirë 5400 pjesëmarrës, prej tyre zyrtarë të arsimit në nivelin komunal, drejtori të shkollave, mësimdhënës, prindër etj.



Hartimi i dokumenteve pedagogjike ka qenë një prej çështjeve po ashtu që i është kushtuar rëndësi gjatë kësaj periudhe meqë ka pasur mungesë të madhe të tyre dhe ajo që vlen të përmendet është Plani Individual i Edukimit (PIA) përfshirë udhëzuesin dhe formularin i cili mund të përdoret nga mësimdhënësit për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore. Në kuadër të kësaj janë zhvilluar shumë trajnime, por akoma kjo mbetet një sfidë për mësimdhënësit se si ta zbatojnë atë në praktikë. Adoptimi i udhëzuesit “Indeksi për gjithëpërfshirje” dhe pilotimi në 8 shkolla filllore dhe të mesme të ulëta, si dhe në 8 Institucione Parashkollore në 8 komuna ka qenë po ashtu një veprim tjetër, i cili ju ka ndihmuar Institucioneve parashkollore dhe shkollave në krijimin e një ambienti më gjithëpërfshirës. Këto janë shkollat dhe institucione parashkollore të para model në Kosovë. Për zbatimin e indeksit janë trajnuar rreth 500 mësimdhënës dhe drejtor të shkollave.” (ZyraeKryeministrit, 2018)

Po nga Plani Nacional për Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2015 janë themeluar edhe ekipet vlerësuese pedagogjike. “Aktualisht 28 komuna kanë caktuar zyrtarët për arsim gjithëpërfshirës, ndërsa 13 Komuna kanë themeluar ekipet vlerësuese profesionale për fëmijët me aftësi të kufizuara. Si rrjedhojë, është hartuar udhëzuesi dhe instrumenti për ekipet vlerësuese profesionale në komuna, me të cilën instrument ata bëjnë vlerësimin e fëmijëve/nxënësve.” (ZyraeKryeministrit, 2018)

Gjatë zbatimit të Planit Nacional 2013-2015 janë vërejtur këto sfida në sektorin e arsimit si: “mungon adaptimi i programeve për ofrimin e edukimit në shtëpi dhe gjatë trajtimit shëndetësor, hartimi i standardeve për PAK për arsimim në nivel universitar, punësimi i mësuesve udhëtues, punësimi i mësimdhënësve mbështetës bazuar në nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, trajnimi i mësuesve udhëtues dhe i asistentëve personal, zhvillimi dhe zbatimi i programeve specifike për intervenimet e hershem si dhe përgatitjet për themelimin e qendrave për identifikim dhe intervenim të hershëm.” (ZyraeKryeministrit, 2018)

Në aspektin ligjor, mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara, është rregulluar dukshëm në vitet e fundit nga Kuvendi i Kosovës. Në një nga ligjet më të rëndësishme në nivel parauniversitar, është edhe Ligji për Arsimin Parauniversitar, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2011. Në këtë ligj, parashihet arsimimi gjithëpërfshirës. “Arsimimi gjithëpërfshirës - përcaktuar në bazë të dispozitave të Konventës së OKB-së për të Drejta të Fëmijës (1989), të Deklaratës së Salamankës të UNESCO-s (1994) dhe 3 Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2007).” (KK, 2011)

## **Conclusion**

Despite strategies, legislation and many documents and administrative instructions, IT education for people with disabilities is quite weak. First, we have a lack of full implementation of the laws in force and accompanying documentation. Secondly, as seen in Table No. 1 within the National Strategy of the Government of Kosovo, in the financial aspect, the investments remain at low budget values, which are also related to the poor and general budget of Kosovo, which for many years, it never even reaches the total value of 3 billion euros. It is mainly about 2 billion euros, where most of the funds are also dedicated to salaries and wages, goods and services. Thirdly, there is a lack of profiling of numerous public universities in all cities of Kosovo, where even the Faculties of Education and Pedagogy fail to prepare specialized staff in special fields for persons with disabilities. Even the professional staff of these faculties are not specialized in special aspects of special and inclusive education. Fourth, the syllabuses do not match the contemporary needs of people with disabilities. Fifth, there is a lack of the most modern technological tools for classes with students with special needs. Sixth, even teachers are not trained enough and properly for access to modern technology for people with disabilities. Seventh, special training is also needed for persons with disabilities for the continuous use of new technological devices, and the maintenance of these technological devices remains a challenge. First, it does not take into account the needs of families with children with disabilities who often live below the poverty line due to various expenses (ie specialty doctors, specialty services, assistive technology, non-ambulatory child care, loss of income) that cannot be overcome regardless of the parents' employment status." (Hunt & Belegu-Caka, 2017) In conclusion, the other weakness remains that for assistive technology devices, responsibility is distributed and thus, accountability cannot be implemented. Likewise, inter-institutional cooperation between the Ministry of Education and Science, the Ministry of Health and the Ministry of Labor and Social Welfare is quite limited, sporadic and weak in most cases, to undertake or promote research and development as well as promote the availability and use of new technologies, including information and communication technologies, mobility aids, assistive technology devices suitable for people with disabilities, giving priority to affordable technologies; provide disabled persons with access to information about mobility aids, devices, and assistive technologies, including new technologies, as well as other forms of assistance, services and support facilities... (Hunt & Belegu-Caka, 2017 )

**Recensentë**

**Basri Ahmeti, Prof. Assoc.**

**Mensur Neziri, Prof. Assoc.**

---

---

**Bibliography**

Hunt, F. P., & Belegu-Caka, V. (2017). *Analiza e situatës: Fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë*. Prishtinë: UNICEF Kosova.

KK. (2011). <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>. Gjetur në <https://gzk.rks-gov.net>

MASHT. (2015). *Funksionalizimi i qendrave burimore*. Prishtinë: MASHT. Gjetur në <https://masht.rks-gov.net>

MASHT. (a.d.). <https://masht.rks-gov.net/divizioni-per-arsim-me-nevoja-te-vecanta>. Gjetur në <https://masht.rks-gov.net>

SHKSH. (2021). <https://www.shksh.org/rreth-nesh/historia/>. Gjetur në <https://www.shksh.org>

UNMIK. (a.d.). [http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/02english/E2006regs/RE2006\\_61\\_schedules.pdf](http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/02english/E2006regs/RE2006_61_schedules.pdf). Gjetur në <http://www.unmikonline.org>

Zyra e Kryeministrit. (2009).

Zyra e Kryeministrit. (2018). *PLANI NACIONAL PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS 2018-2020*. Prishtinë: Zyra e Kryeministrit të Kosovës.